



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2020:066853

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06639440

PAKR.nr.608/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Mentor Bajraktari, kryetar kolegji, Afërdita Bytyçi dhe Valbona Musliu Selimaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B nga fshati Zabërgjë, komuna Klinë, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope apo analoge, nga neni 273 par.2, lidhur me neni 281 par.1, pika 1.9, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale në bashkëkryerje, Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Krimeve të Rënda, si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.B, av. Haxhi Millaku, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.24/2022, i datës 09.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, më datë 11.12.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.24/2022, i datës

09.01.2024, sa i përket vendimit mbi dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin A.B, për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor e gjykon si në vijim:

Për veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, nga neni 273 par.2, lidhur me neni 281 par.1, pika 1.9, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do t'a mbajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë prej 7000 € (shtatë mijë euro), ndërsa dënimi për veprën penale në bashkëkryerje, Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, në shumë prej 500 € (pesëqind euro), i'a merr të vërtetuara, ashtu që në kuptim të nenit 80 të KPK-së, të akuzuarit i shqipton dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do t'a mbajë pas pranimit të këtij aktgjykimi, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.05.2020, e deri me datë 16.10.2020, si dhe masa e arrestit shtëpiak nga data 16.10.2020 e deri me datë 16.02.2021, dhe dënim me gjobë në shumë prej 7500 € (shtatë mijë e pesëqind euro). Dënimin me gjobë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari dështon t'a paguaj gjobën në afatin e caktuar, e njëjta zëvendësohet me dënim me burg, duke i llogaritur 20 (njëzetë) euro me një ditë burgim.

II. Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.B, av. Haxhi Millaku.

III. Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar mbetet i pandryshuar.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.24/2022, i datës 09.01.2024, të akuzuarin A.B, e ka shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, nga neni 273 par.2, lidhur me neni 281 par.1, pika 1.9, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe për veprën penale në bashkëkryerje, Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1, lidhur me nenin 31 të KPK-

së, dhe e ka gjykuar: për veprën penale nga dispozitivi i I-rë, i aktgjykimit të ankimuar me dënim me gjobë në shumë prej 2.500 (dymijë e pesëqind) euro, të cilin dënim i akuzuari është obliguar ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe me dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, e të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Për veprën penale nga dispozitivi i II-të, i aktgjykimit, gjykata i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro të cilin dënim i akuzuari është obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Konform, nenit 80 të KPRK-së, të akuzuarit i është shqiptuar dënim unik dhe atë: dënim unik me gjobë në shumën prej 3000 (tremijë) euro, e të cilin dënim i akuzuari është obliguar që ta paguajë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, e të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë Gjykata do t'ia zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burg për çdo 20 euro të gjobës.

I akuzuari është obliguar të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 273 par.5, të KPP-së, është konfiskuar narkotiku i llojit m..., me peshë prej (52) pesëdhjetë e dy kilogram e (900) nëntëqind gram, një peshore digjitale e llojit Grunding dhe një kompresor Nuair.

Kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal dhe për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore sa i përket vendimit mbi konfiskim, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovë, aktgjykimin e ankimuar t'a ndryshoj, në raport me pretendimet në ankesë ose aktgjykimin ta anuloj dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B, av. Haxhi Millaku, për shkak të vendimit mbi dënim dhe shkeljes se kodit penal, nga neni 387 i KPPK-së, me propozim që Gjykata Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit t'i shqiptoj një dënim me të butë.

Prokurori i Apelit me parashtresën më shkrim, PPA/I.nr.114/2024, të datës 22.02.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, në raport me pretendimet në ankesë ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.B, av. Haxhi Millaku, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PAKR.nr.103/2024, të datës 11.03.2024, ka aprovuar të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, dhe ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.24/2022, i datës 09.01.2024, sa i përket vendimit mbi dënim, ashtu që të akuzuarin A.B, për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor e ka gjykuar si në vijim:

Për veprën penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, nga neni 273 par.2, lidhur me neni 281 par.1, pika 1.9, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, të cilin dënim i akuzuari do t'a mbajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë prej 7000 € (shtatë mijë euro), ndërsa dënimi për veprën penale në bashkëkryerje, Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1, lidhur me nenin 31 të KPK-së, në shumë prej 500 € (pesëqind euro), i'a ka marr të vërtetuar, ashtu që në kuptim të nenit 80 të KPK-së, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 22.05.2020, e deri me datë 16.10.2020, si dhe masa e arrestit shtëpiak nga data 16.10.2020 e deri me datë 16.02.2021, dhe dënim me gjobë në shumë prej 7500 € (shtatë mijë e pesëqind euro). Dënimin me gjobë i akuzuari është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimet të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari dështon t'a paguaj gjobën në afatin e caktuar, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim me burg, duke i llogaritur 20 (njëzetë) euro me një ditë burgim. Është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.B, av. Haxhi Millaku. Në pjesën tjetër aktgjykimi i ankimuar ka mbetur i pandryshuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin, Pml.nr.443/2024, të datës 28.08.2024, ka aprovuar si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit A.B, dhe ka anuluar

aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.103/2024, të datës 11.03.2024, dhe çështjen i' a ka kthyer gjykatës së njëjtë në rigjykim, duke konstatuar se është shkelur dispozita e nenit 384 par. 2, nënpar. 2.7 të KPPK-së, duke obliguar gjykatën e shkallës së dytë që në rigjykim të eliminoj shkeljen e lartpërmendur, të arsyetoj në mënyrë të posaçme rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit me të ashpër në raport me gjykatën e shkallës së parë e pastaj të marrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Gjykata e Apelit, duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.1 të KPPK-së, caktoj dhe mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezantoi mbrojtësi i të akuzuarit A.B, av. Haxhi Millaku, ndërsa nuk prezantoi i akuzuari A.B dhe as Prokurori i Prokurorisë së Apelit, edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tyre. Në seancë mbrojtësi i të akuzuarit, A.B, av. Haxhi Millaku, pasi elaboroj pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, mbeti pranë propozimit të bërë në ankesë që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesa e Prokurorisë Themelore – DKR në Pejë është e bazuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.B, av. Haxhi Millaku, nuk është e bazuar.*

#### *Pretendimet ankimore të Prokurorisë*

Në ankesë Prokuroria Themelore në Pejë thekson se gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit për të akuzuarin A.B, si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka gjetur pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprat penale për të cilat akuzohet, shprehjen e pendimit për veprat e kryera, premtimin se në të ardhmën nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese, gjykata ka gjetur faktin se i akuzuari është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, P.nr.161/2017, të dt. 23.08.2021, të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë. Nga të lartcekurat kjo prokurori çmon se gjykata me rastin e trajtimit të rrethanave lehtësuese për të akuzuarin, gjatë evidentimit të tyre, për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese ka gjetur vetëm

pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimit, premtimin e të akuzuarit se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale, duke i mbivlerësuar të njëjtat rrethana në raport me matjen e dënimit të shqiptuar ndaj të njëjtit. Gjykata vetëm në mënyrë sipërfaqësore ka theksuar se dënimin të cilin i ka shqiptuar të akuzuarit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për forcim të ligjit. Më tutje ka shtuar se gjykata gabimisht i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese duke u përpjekur që rrethanat lehtësuese t'i shumëfishoj në raport me gjendjen faktike. Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese gjykata gabimisht ka evidentuar dhe vlerësuar vetëm një rrethanë të tillë dhe atë faktin se i akuzuari ka qenë më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, duke anashkaluar rrethanat e tjera rënduese dhe atë shkallën e lartë të dashjes dhe shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprat penale për të cilat akuzohet. Në këtë kuptim prokurori vlerëson se nëse Gjykata do t'i trajtonte me kujdes të posaçëm dhe në bazë të provave materiale dhe personale të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, e sidomos ato rënduese, të cilat dominojnë për nga numri në raport me ato lehtësuese, atëherë të akuzuarit, nuk do t'i kishte shqiptuar dënimin unik si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar e që është një dënim i shqiptuar nën minimumin e paraparë me ligj, por do të shqiptonte një dënim më të rëndë e sipas të cilit dënim do të arrihej qëllimi i dënimit.

Lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore sa i përket vendimit mbi konfiskim prokurori në ankesë ka Prokurori ka theksuar se gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit, nuk ka aprovuar propozimin e prokurorisë në lidhje me konfiskimin e pasurisë me arsyetim se prokuroria me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se shtëpia në fjalë e cila gjendet në fshatin Zxxx, komuna Klinë, në ngastrën kadastrale me numër xxx me sipërfaqe prej 5978m<sup>2</sup>, është pronë e të akuzuarit A.B, e po ashtu duke shtuar se gjykata nuk ka prova se shtëpia është dobi pasurore e fituar nga vepra penale, se nuk ka prova që i akuzuari është pronar juridik i asaj shtëpie pasi që sipas regjistrit kadastral pronar i asaj shtëpie, përkatësisht i ngastrës kadastrale referuar si më lartë, është N.S. Për prokurorinë është kontestuese ky konstatim i gjykatës ngase në rastin konkret prokuroria ka paraqitur kërkesën për konfiskim dhe personi i cili evidentohet si pronar i ngastrës kadastrale në asnjë moment nuk ka paraqitur ankesë lidhur me të njëjtën. Fakti që i akuzuari nuk figuron në regjistrat kadastral si pronar i ngastrës në fjalë, përderisa ka prova që e bëjnë

juridikisht posedues faktik të pronës, pronë të cilën i njëjti e ka shfrytëzuar jo vetëm për banim por edhe për të krijuar kushte për realizimin e veprës penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1, pika 1.9 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, vlerësuar nga këto rrethana ka pasur bazë të mjaftueshme për të aprovuar kërkesën për konfiskim, prandaj edhe me rastin e marrjes së vendimit mbi konfiskim, gjykata gabimisht ka vlerësuar faktet mbi bazën e të cilave ka refuzuar propozimin e prokurorisë për konfiskimin e pasurisë dhe atë shtëpisë/pronës e cila evidentohet në ngastrën kadastrale me numër xxxx, ZK, Zxxx, komuna Klinë. Nga e lartë cekura i ka propozuar Gjykatës së Apelit që të vendosë si në propozim të ankesës.

*Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit*

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B, av. Haxhi Millaku, në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar duhet të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin, ngase nuk paraqet proporcionalitetin e vlerësimit mbi veprën penale që i vëhet në barrë të akuzuarit, nuk ka pasoja të dëmshme një nga elementet esenciale, si dhe nga fillimi i procedurës penale/në stacionin policor në Prishtinë, në të gjitha fazat i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe ka bashkëpunuar me drejtësinë. Në prokurori, në fazën e hetimeve ka shprehur vullnetin që të bashkëpunojë me Prokurorinë Themelore në Pejë, këtë e vërteton në mbrojtjen e tij gjatë dëgjimit të tij në zyrën e Prokurorisë ku është negociuar edhe marrëveshja dhe është firmosur por është bërë një keqkuptim për një pronë për konfiskim e cila ka pasur titullar një person tjetër dhe nuk ka pasur të bëjë me të akuzuarin. Kjo gjendje është si faktike ashtu edhe juridike sepse pronar është një person tjetër dhe nuk ka të bëjë me të akuzuarin e as me veprën penale, provat janë në shkresat e lëndës, e çka me të drejtë gjykata shkallës së parë bazuar në ligj vendosi për të mos e konfiskuar pronën në emër të personit të tretë. I akuzuari ka pranuar fajësinë dhe kurrë me parë nuk ka ardhur në kundërshtim me ligjin, njëherit është në cilësinë e mbajtësit të familjes me punën e tij dhe nën kujdesin e përhershëm të babait të tij të paralizuar dhe vazhdimisht kujdeset për trajtimin e tij shëndetësor dhe nevojave të tij. Vendimi mbi dënimin është i rëndë dhe nuk mund të krijoj efekte siç kërkohet me qëllimin e sanksioneve penale, andaj konsideron se është dashur që gjykata të shqiptoj një dënim më të butë me të cilin do të arriheshin të gjitha efektet mbi preventiven dhe represiven e sanksionit penal, me theks të posaçëm ka shumë vite që është kryer vepra penale, viti 2016, pra mbi 8 vite nga koha e kryerjes së sajë. Ka shtuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me figurën e veprës penale e cila i vëhet në barrë të akuzuarit sipas aktakuzës dhe se kjo rezulton edhe nga dispozitivi dhe vet arsyetimi i aktgjykimit të atakuar, nga shkakun se elementet qenësorë të veprës penale nuk janë formësuar, nuk ka kryer veprimet që manifestohet vepra penale dhe gjykata fare nuk u

lëshua në faktin se si erdhi situata tek përshkrimi faktik i veprimeve individualisht të përcaktuara nga i akuzuari por në mënyrë të përgjithësuar ka përpiluar dispozitivin e akuzës dhe përshkrimin e veprimeve. Konsideron se Gjykata e shkallës së dytë do të vlerësoj dhe ndryshoj edhe cilësimin juridik të veprës penale, pasi që tiparet cilësuese të veprës penale edhe në përshkrimin faktik të dispozitivit nuk mund të paraqesin këtë veprë penale apo cilësimin juridik të tillë, sidomos elementin kualifikues të veprës ngase nuk ekziston si i tillë. Mbrojtja konsideron se ankesa duhet aprovuar, sepse si e tillë është e bazuar, andaj nga e cekura ka propozuar si më lartë.

### *Gjetjet e Gjykatës së Apelit*

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë edhe pse me ankesë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt – konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin më kushtëzuar anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, me ankesa nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate meqenëse konform dispozitës së nenit 383 par.2 të KPPK-së, as që mund të kontestohet aktgjykimi i ankimuar përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuari A.B ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësorë dhe gjykata shkallës së parë ka aprovuar pranimin e fajësisë, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Edhe pse mbrojtësi i të akuzuarit aktgjykimin e ankimuar e atakon për shkak të vendimit mbi dënim gjatë shtjellimit të pretendimeve ankimore në ankesë thekëson se aktgjykimi i ankimuar përmban edhe shkelje të ligjit penal duke shtuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me figurën e veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit sipas aktakuzës dhe se kjo rezulton nga dispozitivi dhe vet arsyetimi i aktgjykimit të atakuar, nga shkak se elementet qenësorë të veprës penale nuk janë formësuar.

Kolegji gjen se pretendimet ankimore për shkelje të ligjit penal janë të paqëndrueshme në raport me të akuzuarin A.B, se me aktgjykimin e ankimuar nuk është shkelur ligji penal siç pretendon mbrojtësi, për faktin se në gjendjen e fakteve të provuara nga vetë pranimi i fajësisë së të akuzuarit, në veprimet e të akuzuarit formësohen tiparet subjektive dhe objektive të veprës



penale, Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge, nga neni 273 par.2, lidhur me neni 281 par.1, pika 1.9, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, se për këtë veprë penale i njëjti është penalisht përgjegjës, si dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të akuzuarit.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit për dënim më të ashpër, janë të bazuara, ndërsa pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit për një dënim me të butë, nuk janë të bazuara.

Kolegji vlerëson se pretendimet e prokurorisë lidhur me vendimin mbi dënim janë të bazuara për faktin se rrethanat lehtësuese të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë se i akuzuari ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendimin për veprën e kryer, ka premtuar se në të ardhmën nuk do të kryej vepra tjera penale, janë mbivlerësuar. Po ashtu të bazuara kolegji gjen edhe pretendimet ankimore të prokurorit se rrethanat rënduese në raport me të akuzuarin nuk janë vlerësuar drejtë nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Andaj, në rastin konkret pretendimi i prokurorisë se në raport me të akuzuarit ekziston si rrethanë rënduese shkalla e lartë e dashjes dhe shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar në kryerje të veprave penale, është i bazuar. Më konkretisht, kolegji gjen se i akuzuari nga mënyra që rezulton se ka kryer veprën penale është vërtetuar se ka poseduar substancat narkotike me qëllim që ta eksportoj në Austri, çka konsiston në veprime të kryerjes së veprës penale. Si mënyrë e kryerjes duke qenë se i akuzuari veprimet i kishte ndërmarrë në drejtim që substancën narkotike ta eksportoj në Austri, çka e bën këtë rrethanë të rëndësishme nga pesha, duke qenë se objekt i përgjithshëm i mbrojtjes i kësaj veprë penale është shëndeti i njerëzve, ndërsa pasoja e saj është në rrezikshmërinë e shëndetit të njerëzve, e që veprimet e tilla kanë rrezikshmëri të lartë. Në anën tjetër, fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale dhe ka pranuar fajësinë në këndvështrim me të gjitha rrethanat rënduese që janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, por dhe nga të dhënat nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale ku ka rezultuar se i akuzuari është dënuar me aktgjykim të formës së prerë dhe atë nga Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, P.nr.161/2017, të datës 23.08.2021, kjo tregon për personalitetin e tij dhe mungesën e arritjes së qëllimit të dënimit, gjithnjë duke marrë për bazë se i njëjti nga viti 2021, rezulton se është dënuar për veprë penale me aktgjykimin e theksuar më lartë.

Andaj, për këto shkaqe kolegji edhe e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë të bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, ashtu që i akuzuari të mos kryej vepra penale në të ardhmën, dhe po ashtu do të këtë efekt edhe në raport me kryerësit potencial që të njëjtit të abstenojnë nga kryerja e veprave penale, e kjo padyshim shpërfaq gjykim shoqëror për veprimet inkriminuese dhe forcon moralin për respektimin e ligjit, e me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Në anën tjetër, kolegji gjeti si të pabazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, se i akuzuari A.B ka pranuar fajësinë dhe kurrë me parë nuk ka ardhur në kundërshtim me ligjin, se është në cilësinë e mbajtësit të familjes me punën e tij dhe nën kujdesin e përhershëm të babait të tij të paralizuar dhe vazhdimisht kujdeset për trajtimin e tij shëndetësor dhe nevojave të tij, ndërsa në anën tjetër në ankesë përveç atyre rrethanave lehtësuese të cekura në gjykatën e shkallës së parë nuk potencohet ndonjë rrethanë tjetër e re e cila nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj kjo Gjykatë referuar këtyre gjetjeve nga gjykata e shkallës së parë gjen se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi ndaj të akuzuarit është përkatës në raport me rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale si në dispozitiv të aktgjykimin të ankimuar.

Kolegji gjen të pabazuar pretendimin e prokurorisë se gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimin, nuk ka aprovuar propozimin e prokurorisë në lidhje me konfiskimin e pasurisë shtëpisë e cila gjendet në fshatin Zxxx, komuna Klinë, në ngastrën kadastrale me numër xxx, me sipërfaqe prej 5978m<sup>2</sup>, e cila është pronë e të akuzuarit, pronë të cilën i akuzuari e ka shfrytëzuar jo vetëm për banim por edhe për të krijuar kushte për realizimin e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Kolegji vlerëson se gjykata shkallës së parë drejtë ka vepruar kur nuk ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore ne Pejë – Departamenti për Krime të Renda për konfiskimin e shtëpisë (pronës) ku jeton i akuzuari, për konfiskimin e shtëpisë se cekur në propozim për konfiskim, për arsye se Prokuroria me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se shtëpia në fjalë e cila gjendet fshatin Zxxx, komuna Klinë, në ngastrën, kadastrale me numër, xxxx, me sipërfaqe prej 5978 m<sup>2</sup>, është pronë e të akuzuarit A.B. Po ashtu Prokuroria me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se shtëpia është dobi pasurore e fituar nga vepra penale. Gjykata nuk ka prova se i akuzuari është pronar juridik i asaj shtëpie pasi që sipas regjistrit kadastral pronarë i asaj shtëpie përkatësish i asaj ngastre kadastrale me numër xxx, me sipërfaqe prej 5978 m<sup>2</sup>, është N.S, ndërsa prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë se këtu i akuzuari në ndonjë mënyrë e

ka fituar të drejtën e pronësi në atë shtëpi, nuk ka ndonjë punë të vlefshme juridike që do të argumenton bartjen e pronësisë nga N.S, tek i akuzuari A.B. Andaj, meqenëse nuk ka prova që vërtetojnë pronësinë e të akuzuarit në atë shtëpi, e po ashtu nuk ka prova se shtëpia është pasuri e fituar me vepër penale, pretendimi i prokurorisë në ankesë lidhur më konfiskimin e shtëpisë së cekur në lartë është i pabazuar.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 dhe 403 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për Krime të Rënda  
PAKR.nr.608/2024, datë 11.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Kryetari i kolegjit

---

Fitore Batatina

---

Mentor Bajraktari

Anëtarët e kolegjit:

---

Afërdita Bytyçi

---

Valbona Musliu Selimaj